



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

“VLERËSIMI I BESUESHMËRISË”

PERCEPTIMI I SIGURISË PUBLIKE NË
KOSOVË

10 qershor 2008

RAPORTI PËRMBLEDHËS

Raporti “Vlerësimi i besueshmërisë”, reflekton mbi opinionin e popullatës në punën e bërë nga institucionet vendore të Kosovës për Siguri Publike. Informatat e nxjerra janë të bazuara nga një sondazh¹ i mbajtur në tërë Kosovën gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2007 gjatë kohës kur mbaheshin negociatat për statusin e Kosovës.

Informata kryesore e marrë nga ky sondazh është se perceptimi i përgjithshëm publik në lidhje me punën e organeve të Sigurisë Publike në Kosovë është i mirë. Të intervistuarit kanë deklaruar se i besojnë KFOR-it, Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Shërbimit Policor të Kosovës, Njësive të Gatishmërisë Emergjente mirëpo i besojnë më pak disa institucione tjera, kjo kryesisht për shkak të mungesës së informatave për ekzistimin e këtyre institucioneve. Edhe pse studimi me anë të së cilit është përgatitur ky raport tregon se ekziston një nivel mjaft i mirë i besimit të qytetarëve ndaj Shërbimit Policor të Kosovës si një institucion, megjithatë duhet të i përmendim deklaratat për disa raste të shkeljeve të zyrtarëve policorë të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në gjykimin e përgjithshëm të qytetarëve për Shërbimin Policor të Kosovës si një tërësi.

Ky raport tregon një sërë mungesash të bazuara në rezultatet e intervistave të ndara sipas komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Shumë pjesëtarë të komunitetit serb (në jug) si dhe të komunitetit shqiptarë (në veri) kanë deklaruar se nuk janë ndier të sigurt, si dhe nuk i kanë besuar organet e Sigurisë Publike në mjediset e tyre.

Në përgjithësi, individët e intervistuar ishin të brengosur për kualitetin e punës së Shërbimit Policor të Kosovës në këto çështje:

- Luftimi i rasteve të grabitjeve
- Çështja e parkimit ilegal (posaçërisht e theksuar në Prizren)
- Nevoja për shpeshimin e patrullave policore përreth objekteve shkollore në mënyrë që të parandalohen incidentet e mundshme në oborret shkollore.

Individët e intervistuar besojnë se rastet e shpeshta të paraqitjes joefektive të Shërbimit Policor të Kosovës ishin për shkak të mungesës së profesionalizmit dhe për shkak të nepotizmit brenda shërbimit, si dhe për shkak të perceptimit se ka mangësi në përzgjedhjen e policisë si dhe në procedurat e trajnimit të Shërbimit Policor të Kosovës.

Veç kësaj, të intervistuarit gjatë diskutimeve, shfaqën brengat e tyre për efektshmërinë e **Institucioneve e Drejtësisë**² si dhe të **Shërbimit Korrektues**.

Rezultatet e nxjerra gjithashtu tregojnë se të anketuarit:

- Në të shumtën e rasteve nuk ishin të informuar mbi ekzistimin e **Inspektoratit Policor të Kosovës**³, prandaj edhe kishin mungesë të njohurive për punën dhe përgjegjësitë e këtij institucioni.
- Shumicën e rasteve nuk ishin të informuar për punën e Agjensionit Kosovar Kundër-Korrupsionit.
- Shumicën e rasteve nuk ishin të informuar me punën e Njësive të Policisë në Komunitete të Shërbimit Policor të Kosovës.

¹ Mostra përbëhej nga 1700 intervista individuale dhe shtatë debate në grupe të fokusit, në prani të 200 pjesëmarrësve. Mostra për intervista individuale përbëhej nga tre nën-mostra me 1360 shqiptarë të Kosovës, dhe 340 jo-shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç.

² Institucionet e drejtësisë përfshijnë, gjykatat, prokurorinë dhe trupat tjera relevante të drejtësisë.

³ Si reagim në këtë fakt, OSBE Misioni në Kosovë, Departamenti për Siguri Publike, në janar të vitit 2008 ka zhvilluar një kampanjë publike për të promovuar Inspektoratin e Policisë para publikut.

Të anketuarit e konsideronin si të rëndësishëm **Shërbimin Doganor**, mirëpo dyshonin për familjarizëm në mesin e disa zyrtarëve si dhe kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për importimet e pakontrolluara siç janë ushqimet dhe barërat e skaduara,, duke i identifikuar këto raste si rreziqe serioze të Sigurisë dhe Mbrojtjes Publike në Kosovë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje.....	4
2. Organet kryesore të sigurisë dhe përgjegjësit e tyre	4
3. Perceptimi i punës së kryer nga ofruesit e Sigurisë.....	5
4. Perceptimi i përgjithshëm i rrezikut në Kosovë.....	8
4.1. Vlerësimi i rrezikut në mbarë Kosovën si dhe në nivelet lokale.....	8
4.2. Debatet e grupeve të fokusit- studim kualitativ.....	9
4.3. Perceptimet nga këndvështrimi i Komuniteteve.....	11
4.4. Perceptimet e Komunitetit Serb.....	11
5. Marrëdhëniet mes ofruesve të Shërbimeve të Sigurisë Publike.....	13
6. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	15
7. Aneksi: Metodologjia e përdorur.....	17

1. HYRJE

Ky raport prezanton konkluzionet e nxjerra gjatë sondazhit të bërë me qëllim të përkrahjes së planifikimit strategjik të aktiviteteve të OSBE-së Misionit në Kosovë lidhur me çështjet e Sigurisë Publike. Misioni dëshiron t'i bartë informatat e nxjerra tek Qeveria e Kosovës si dhe tek Institucionet përkatëse të Sigurisë publike.

Ky raport është pjesë e përpjekjeve gjithëpërfshirëse të Misionit në mënyrë që të shikoj me thellë në performancën e institucioneve lokale të sigurisë e cila ka ndikim në jetën e banorëve të Kosovës.

Disa ngjarje të rëndësishme së veçantë politike ndodhën gjatë implementimit të këtij sondazhi. Rrethanat e sigurisë dhe zhvillimet në Kosovë ishin të tendosura dhe të ndërlikuara në kohën kur mbaheshin negociatat lidhur me statusin

Niveli i sigurisë siç ishte kuptuar nga intervistuesit ishte i larmishëm në aspekte të ndryshme. Ata në shumicën e rasteve kishin ndjenja të përziera gjatë përgjegjës në pyetjet lidhur me perceptimet e tyre për sigurinë. Shumica kanë ndier nivelin e rrezikut të cilin nuk kanë mundur ta përshkruajnë në detaje mirëpo të anketuarit thoshin se ata nuk ndjehen të sigurt. Ishte një perceptim i përbashkët i tyre që situata në atë kohë mbetej e pasigurt sa i përket situatës së sigurisë me pasojë të mundshme për stabilitetin në Kosovë.

Ky raport është pjesë e përpjekjeve të Departamentit që të vlerësoj perceptimin e publikut lidhur me punën e institucioneve lokale të Sigurisë Publike në Kosovë. Një sondazh i tillë mendohet të bëhet në vjeshtë të vitit 2008, në mënyrë që të vlerësohet nëse informatat (perceptimet) e publikut kanë ndryshuar nga të dhënat e mbledhura në fund të vitit 2007 duke marrë parasysh se disa pikëpamje mund të jenë ndikuar nga ngjarjet e pjesës së parë të vitit 2008

2. OFRUESIT KRYESORË TË SIGURISË DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Shërbimi Policor i Kosovës është themeluar nga UNMIK-u (Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara të Misionit në Kosovë) nën autoritetin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të 10 qershor 1999. Aktualisht, Shërbimi Policor i Kosovës përbëhet prej më shumë se 7.500 zyrtarëve policorë. Përgjegjësia kryesore e saj është të kontrollojë sigurinë dhe të mbajë rendin publik në Kosovë. Fillimisht, Shërbimi Policor i Kosovës ishte tërësisht nën autoritetin e Policisë së UNMIK-ut. Gradualisht Policia e UNMIK-ut transferoj tek Shërbimi Policor i Kosovës përgjegjësitë për ligjin dhe rendin si dhe funksionimin e policisë kufitare. Pothuajse të gjitha pajisjet policore i janë kaluar Shërbimit Policor të Kosovës

Policia e UNMIK-ut, me një përbërje prej 1.500 Zyrtarëve Civil-Policor Ndërkombëtarë, në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës, ndihmon në garantimin e ambientit të sigurt në Kosovë dhe posaçërisht mundëson përkohësisht zbatimin e ligjit⁴. Kompetencat e saja po zvogëlohen meqë roli i Shërbimit Policor të Kosovës është në rritje.

Inspektorati Policor i Kosovës, është një trup i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Është një mekanizëm i sapoformuar dhe detyra kryesore e saj është të mbikëqyr performancën e Shërbimit Policor të Kosovës si dhe të siguroj përgjegjësinë dhe transparencën e saj. Inspektorati shqyrton me kujdes efikasitetin e menaxhimit, efikasitetin në pajtim me

⁴ Shiqo <http://www.civpol.org/unmik/mandate.htm>

strukturën⁵ ligjore të sapoformuar si dhe të hetoj shkeljet e mundshme të punëtorëve të Shërbimit Policor të Kosovës.

Shërbimi i Zjarrfikës dhe i Shpëtimit përgjegjësi parësore e tyre është të merren me zjarret dhe fatkeqësitë natyrore që ndodhin në Kosovë. Janë pjesë e Departamentit të Menaxhimit të Emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme mirëpo funksionon nën përgjegjësinë e komunave përkatëse. Këto shërbime gjithashtu iu përgjigjen rasteve të tjera urgjente, siç janë tërmetet, përmytjet dhe ballafaqimi me rastet tjera të mbrojtjes civile.

Shërbimi Doganor është kompetencë e rezervuar e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës e cila mban përgjegjësinë administrative dhe operacionale. Përparësitë kryesore të Doganës së UNMIK-ut janë të mbledh dhe mbron të ardhurat për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës; të ndihmoj dhe legjitimoj tregun duke rivendosur procedurat doganore dhe duke i adaptuar ato në praktika dhe teknika moderne doganore. Më tutje ajo mbron shoqërinë dhe legjitimon tregun duke ndjekur dha parandaluar kontrabandën dhe mashtrimin⁶.

Shërbimi Korrektues funksionon nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Merret me çështjet që i përkasin sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues dhe ofron siguri në burgje si dhe mbron të dhënat personale në lidhje me shërbimin e saj.

NATO-KFOR (Forca në Kosovë) ka mandat të bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i KFOR-it është të krijoj dhe mban ambientin e sigurt në Kosovë⁷. KFOR-i ka përafërsisht 16.000 ushtarë në Kosovë dhe përpos detyrave tjera ka edhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë ta mbrojë Kosovën nga kërcënimet e jashtme.

Trupat Mbrojtëse të Kosovës është organizatë civile për shërbime emergjente. Është krijuar në baza të përkohshme sipas Rregullores 1999/8 të UNMIK-ut, më 20 Shtator 1999. Përgjegjësitë e saja përfshijnë detyrat si: reagime në fatkeqësi të ndaloj zjarre të mëdha dhe aksidente industriale; operacionet e kërkim shpëtimit; furnizim me ndihma humanitare; asistime në deminim; të jap kontributin në rikonstruktimin e infrastrukturës dhe komuniteteve. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron drejtimin, sponzorimin dhe autoritetin administrativ.

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit është një trupë e pavarur e sapoformuar nga Ligji Kundër Korrupsionit 2004/34, i nxjerrë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/26 të 12 maj 2005. I mbikëqyr institucionet lokale dhe heton aktivitetet e mundshme të korrupsionit. Agjencioni Kosovar për Kundër Korrupsion ka filluar punën e saj më 17 Korrik 2006 me caktimin e një drejtori dhe është bërë funksionale që nga muaji shkurt 2007


3. PERCEPTIMI I PUNËS SË KRYER NGA OFRUESIT E SIGURISË PUBLIKE

Në përgjithësi të anketuarit kanë deklaruar se ata i besojnë ofruesit kryesorë të sigurisë në Kosovë. Ata më pak i besonin disa institucioneve tjera mirëpo kjo nuk kishte të bëjë me kualitetin e punës por kryesisht me faktin se ata nuk ishin të informuar për ekzistencën e këtyre institucioneve.

⁵ Shiko Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54 dhe Udhëzimin Administrativ 2006/9.

⁶ http://www.euinkosovo.org/uk/about/about_pillarcomp.php


⁷ <http://www.nato.int/kfor/docu/about/objectives.html>



Grafika 1: *Cilit institucion i besoni më së shumti?*


Duke kërkuar nga të anketuarit që të japin vetëm një përgjigje në pyetjen: “Cilit institucion të sigurisë i besoni më së shumti?”, 33% nga ata kanë renditur KFOR-in dhe Shërbimin Policor të Kosovës në krye të listës, përderisa trupat Mbrojtëse të Kosovës u radhitën të tretët me radhë më 29%. Niveli i ulët i besimit në Shërbimin e Zjarrfikësve mund të shpjegohet nga fakti se shumica e të anketuarve nuk kanë qenë asnjëherë në situata urgjente ku është nevojitur ndihma e këtij shërbimi. Ata të cilët kishin nevojë për ndihmën e zjarrfikësve thanë se kanë pasur përvojë të mirë me Zjarrfikësit.

Të pyetur sa janë të kënaqur me punën e kryer nga ofruesit e Sigurisë Publike, shumica e të anketuarve (60%) deklaruan se janë “shumë” apo “pjesërisht” të kënaqur, përderisa 28% e të anketuarve kanë shprehur nivel të ulët të kënaqësisë. 9% e tyre kanë deklaruar se se nuk janë aspak të kënaqur.



Grafika 2: *Niveli i kënaqësisë në efektshmërinë e mekanizmave të sigurisë të Kosovës.*

Në përgjithësi, perceptimi i performancës së **Shërbimit Policor të Kosovës** ishte pozitive, mirëpo sistemi i tashëm i trajnimit të policisë ishte konsideruar si jo i mjaftueshëm për të zhvilluar një zyrtarë policorë të kualitetit të lartë.



Grafika 3: Sa kompetente, mendoni, është Shërbimi Policor i Kosovës?

Rreth 17 % e të anketuarve e konsiderojnë Shërbimin Policor të Kosovës si mjaft kompetent, përderisa shumë prej të anketuarve (33 %) i përshkruajnë kompetencat e Shërbimit Policor të Kosovës si “mjaft të mira sa për të punuar”; 29% mendonin se policia nuk është mjaft kompetente për punë, përderisa rreth 16% menduan që policia nuk është fare e aftë për t’i kryer detyrat e saja.

Në pyetjen nëse OSBE-ja do të duhej të kishte një rol në përmirsimin e efektshmërisë së Shërbimit Policor të Kosovës, shumica e të anketuarve (68%) besonin se OSBE-ja mund të ndihmojë; 6 % të tyre nuk kanë besuar se OSBE-ja do të mund ta bëjë këtë dhe 26 % e tyre deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë.

Perceptimi i punës së **Institucioneve të Drejtësisë** ka qenë negative sepse të anketuarit dyshonin në nivel të lartë të korrupsionit dhe joefikasiteti në ndriçimin e rasteve që kanë të bëjnë me gjyqësorin. Më tutje, ikja e disa të burgosurve nga burgu u Dubravës/Dubrava⁸ si duket ka dëmtuar reputacionin e **Shërbimit Korrektues**


Shërbimi Doganor konsiderohej i rëndësishëm, por njerëzit kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me importimet e pakontrolluara të ushqimeve dhe medikamenteve të skaduara.. Ata e shihnin këtë si kërcënim serioz për sigurinë e tyre.

Efektshmëria e **Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit** çmohej shumë edhe pse të anketuarit kishin njohuri mbi kushtet e dobëta të punës si dhe pajisjet e mangëta me të cilat ballafaqohet ky shërbim.

⁸ Me 18 gusht 2007 pas një incidenti në burgun e Dubravës/Dubrava, në Istog/Istok shtat të burgosur ia dolën të ikin nga burgu (<http://www.unmikonline.org>)

4. PËRCEPTIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIKUT NË KOSOVË

Përderisa negociatat për statusin e Kosovës kanë dominuar agjendën politike të vitit 2007, tensionet rriteshin. Ishte një perceptim publik (i mbështetur nga mediat ditore) se Beogradi do të imponoj masa të sigurisë nëse Kosova në mënyrë të njëanshme shpallë pavarësinë e saj. Disa pjesëtarë të armatosur të organizatës paramilitare të Shqiptarëve të Kosovës “Armata Kombëtare Shqiptare” (AKSH) janë paraqitur në media duke pretenduar se janë “Mbrotjtësit e Kosovës”



Grafika 4: Perceptimi i përgjithshëm i publikut për nivelin e rrezikut në Kosovë

Më pas, institucionet lokale kanë deklaruar se ata ishin të gatshëm të mbrojnë popullatën nga çfarëdo kërcënimi të ndonjë grupi⁹. Në këtë situatë të pasigurt dhe të tensionuar u mbajt sondazhi prandaj kjo edhe mund të ndihmojë në shpjegimin e disa rezultateve të nxjerra.

Të anketuarit e pyetur, pavarësisht se cilit komunitet i përkasin: “Si e perceptoni nivelin e rrezikshmërisë në Kosovë”, siç edhe është ilustruar më lartë, 18 % e të anketuarve mendonin se është shkallë e lartë e rrezikut në Kosovë, 48 % e të anketuarve mendonin se rrezikshmëria është në shkallë mesatare, 19 % besonin se është shkallë e ulët e rrezikshmërisë. Ndërsa 7% e të anketuarve deklaruan se nuk ka fare rrezik në Kosovë.

4.1 Vlerësimi i rrezikut në tërë Kosovën dhe në nivelet lokale

Në nivelin mbarë kosovar, zhvillimet e pasigurta në sektorin sigurisë (me mundësinë e infiltrimit të disa grupeve të armatosura) të ndërlydhura me, negociatat e atëhershme për statusin e Kosovës, janë vlerësuar si rrezik. Këto çështje janë ngritur si brengë në të gjitha debatet e grupeve të fokusit në mbarë Kosovën. Duke parë situatën politike, aktivitetet e strukturave paralele, në veçanti në rajonet e banuara me serb të Kosovës, ishte shkak për brenga të shqiptarëve të Kosovës të cilat u ngritën gjatë debateve në grupe të fokusit në Prishtinë/Priştina¹⁰. Në Gjilan/Gnjilane menaxhimi i vijës kufitare administrative është përmendur si brengë e sigurisë. Në pyetjen që të identifikojnë çështjet e sigurisë të cilat janë paraqitur në nivelin lokal, rreziku i cili është përmendur nga të anketuarit ishte më shumë i ndërlydhur me sigurinë individuale se sa me atë të përgjithshme në Kosovë. Çështja e

⁹ 04 tetor 2007, transmetuesi publik RTK dhe Agjensioni I Lajmeve Kosova Live

¹⁰ Në veçanti janë përmendur aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë si dhe strukturat paralele në fushën e drejtësisë.

vjedhjeve me thyerje e cila është përmendur në shumicën e debateve të grupeve të fokusit, është konsideruar si rrezik i vazhdueshëm për sigurinë individuale dhe pasurinë. Pjesëmarrësit në Gračanica/Graçanicë në vazhdimësi kanë potencuar se situata në rajonin e tyre ka qenë jo stabile dhe e pasigurt, dhe pjesëmarrësit në grupet e fokusit e kanë vënë në pah ndjenjën e frikës. Në Pejë/Peć pjesëmarrësit thanë se gjërat ushqimore të importuara në Kosovë nuk i përmbushin kriteret shëndetësore dhe higjienike prandaj këtë e konsiderojnë si rrezik të mundshëm.

Të pyetur se çfarë do të konsideronin si **kërcënim strukturor** për sigurinë e tyre në Kosovë disa të anketuar në debatet e grupeve të fokusit kanë përmendur çështjet ditore sociale që ata mendojnë se ua vështirësojnë përditshmërinë e tyre siç janë menaxhimi i dobët publik, mungesa e ujit, rryma apo dhe inflacioni.

Megjithatë, është më se e evidente se **negociatat për statusin e Kosovës** në momentin e intervistave kishin një ndikim shumë të madh në njerëzit, sa që 41% e të anketuarve çështjen e statusit e kanë paraqitur si pikën e parë kritike.

Ndërsa 9% e të anketuarve konsideronin **gjendjen socio-ekonomike** si rrezik të mundshëm të sigurisë, ndërsa 9% të tjerë nga të anketuarit si më të rrezikshme paraqesin **gjetjen dhe mbajtjen e vendit të punës**. Nga këndvështrimi i tyre papunësia është çështje sociale mbarë kosovare dhe shihet si problem i cili është ende larg prioriteteve të qeverisë. Për 8%, **grupet e armatosura ilegale** ishin çështje brengosëse dhe 5% e të anketuarve theksuan se implementimi i **rendit dhe ligjit** nuk është i mjaftueshëm edhe pse kishte një mbështetje të theksuar nga komuniteti ndërkombëtar. 5% e të anketuarve e kanë parë korrupsionin si faktorë të mundshëm destabilizues për sigurinë. 16% e njerëzve nuk janë përgjigjur në pyetjen se çfarë do të konsideronin ata si kërcënim struktural.

4.2. Debatet e grupeve të fokusit – hulumtimi kualitativ

Edhe pse studimi paraqet një nivel të pranueshëm të besueshmërisë në institucionet e sigurisë, situata mbetet e tensionuar në sferën e sigurisë personale si p.sh. vjedhjet, lëndimet trupore ose kidnapimet, ngase këto kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve se sa situata e përgjithshme. Njerëzit ishin të brengosur për shkak të paraqitjes së dobët të Shërbimit Policor të Kosovës në përpjekjet për të identifikuar dhe arrestuar vjedhësit e shtëpive. Kjo çështje sidomos është përmendur në debatet e grupeve të fokusit në Pejë/Peć, Prizren dhe Gračanica/Graçanicë. Njerëzit e kanë përmendur se anëtarët e familjes shpesh qëndrojnë në shtëpitë e tyre për të parandaluar vjedhjet gjë e cila e bënë jetën e tyre dhe më të vështirë. Ata thanë se vjedhjet e shtëpive janë më të shprehura gjatë sezonës së verës kur vizitorët vinë në Kosovë.

Në Prizren çështja më e përmendur kishte të bënte me parkimin ilegal të makinave në trotuare gjë që paraqet rrezik për shkollarët. Një pjesëmarrës tha: “Nëse fëmija im nuk ndjehet i sigurt si mund të flasim për sigurinë në përgjithshme?” Pjesëmarrësit në vazhdimësi kanë kërkuar shtimin e patrullave të Shërbimit Policor të Kosovës përreth institucioneve edukative. Disa nga pjesëmarrësit thanë se ishte domosdoshmëri angazhimi i kompanive private të sigurisë dhe dha disa nga shembujt e suksesshëm të rajoneve të tyre si Prishtinë/Priština dhe Pejë/Peć. Të tjerët kanë parashtruar pyetjet: “Pse duhet të paguajmë për shërbimet e kompanive private të sigurimit nëse policia është përgjegjëse për sigurinë në përgjithësi?” Përfaqësuesit e Shërbimit Policor të Kosovës shfaqën brengat e tyre dhe thanë se mungesa e pjesëtarëve të policisë është si rezultat i mungesës së personelit.

Në përgjithësi, shfaqën dyshimin e tyre në efektshmërinë e Shërbimit Policorë të Kosovës për shkak të perceptimit se ka mungesë të profesionalizmit brenda shërbimit. Pjesëmarrësit thanë

se trajnimi bazik nëntë javor¹¹ nuk është i mjaftueshëm për zyrtarë policor profesional. Kishte raste kur njerëzit prezantuan fakte si raportin nga vendi i ngjarjes, i cili paraqiste aftësitë e pamjaftueshme të zyrtarëve të policisë të cilët përpiluan dokumentet.

Më pas, pjesëmarrësit kanë kritikuar procedurat e rekrutimit ngase ata besonin se e kaluara e zyrtarëve të rinj të policisë nuk është marrë në konsideratë. Pothuajse që të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar për nevojën e rishikimit të programit edukative dhe trajnues për Shërbimin Policor të Kosovës¹². Të gjitha çështjet e përmendura i referoheshin periudhës së shkurt të trajnimit bazik për kadetët policor të saporekrutuar. Veç kësaj, jo vetëm periudha fillestare e trajnimit ishte çështje brengosëse.

Kriteret e rekrutimit të zyrtarëve të policisë gjithashtu janë konsideruar si çështje brengosëse. Për të arritur gradën e kolonelit, zyrtarët policor nuk kanë nevojë të kenë arsimim të lartë universitar; ishte e mjaftueshme që të kenë të mbaruar vetëm shkollën e mesme që të promovohen në rangun e një zyrtari të lartë. Kjo çështje është përsëritur në vazhdimësi në debate.

Paraqitja e **institucioneve të drejtësisë** është konsideruar si më e dobëta në mesin e të gjitha institucioneve për siguri publike gjatë diskutimeve në debatet e grupeve të fokusit. Publiku e sheh si të pamjaftueshme performancën e këtyre institucioneve. Ata thanë se edhe pse institucionet e drejtësisë nuk konsiderohen si akterë të drejtpërdrejtë të sigurisë, jofikshmëria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë në mekanizmat tjera të sigurisë.

Bashkëpunimi me Shërbimit Policor të Kosovës dhe institucioneve të drejtësisë është konsideruar si i dobët. Kjo çështje është përmendur sidomos nga pjesëmarrësit në Pejë/Peç: “Policia e bënë mirë punën e saj, por prokuroria dhe gjyqësori jo”. Gjatë debatit në grupin e fokusit në Prishtinë/Priština, në veçanti është përmendur se edhe pse **Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit** ka iniciuar disa raste, ata, sidoqoftë, nuk i kanë bërë publike rezultatet përfundimtare të punës së tyre mbase për shkak të ndjeshmërisë së rasteve. Kjo mund të konsiderohet si arsye pse të anketuarit nuk kishin njohuri mbi punën e Agjencionit. Krahas implementimit të hulumtimit, OSBE Misioni në Kosovë ka zhvilluar një kampanjë për ekzistencën e Agjencionit Kundër korrupsionit. Për shkak të kohës së shkurtër mes hulumtimeve, rezultatet e kampanjës të cilat edhe mund ta kenë ngritur nivelin e vetëdijimit për Agjencionin kundër korrupsionit, nuk janë reflektuar në këtë hulumtim.

Në të gjitha debatet e grupeve të fokusit pjesëmarrësit e kanë kritikuar **Shërbimin Korrektues**, duke vënë në pah ikjen e të burgosurve nga burgu i Dubravë/Dubrava dhe shtuan se ata janë të vetëdijshëm se kjo paraqet një rrezik për shoqërinë.

Gjatë diskutimeve për sistemin e drejtësisë në debatet në Gjilan/Gnjilane, disa pjesëmarrës argumentuan se **UNMIK-u** nuk ia doli të vendosë një sistem të qëndrueshëm dhe të drejtë. Pjesëmarrësit në këtë rajon deklaruan se sistemi i tanishëm i drejtësisë nuk ishte funksional për shkak të prezencës së gjykatësve ndërkombëtar të UNMIK-ut si dhe për shkak të prokurorëve të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi shoqërinë kosovare.

Përkundër mangësive të makinave për zjarrfikje dhe shpëtim dhe pajisjeve tjera për luftimin e zjarrit njerëzit shfaqën kënaqësinë e tyre me punën e **Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit**. Edhe pse të anketuarit deklaruan se këto njësi nuk janë ndër mekanizmat primare të sigurisë

¹¹ Trajnimi bazik për kadetët në shkollën e policisë në Vushtri/Vuçitrn, e cila menaxhohet nga OSBE, që nga fillimi deri në diplomim ka ndryshuar që nga viti 1999 prej gjashtë javëve në tetë javë dhe më pas është avancuar në 12 javë dhe së fundi në 20 javë.

¹² Kjo çështje nuk është përmendur vetëm në Prizren por edhe në Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština dhe Pejë/Peç.

megjithatë kishin njohuri të mjaftueshme për specifikat e punës së tyre. Puna e Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit është vlerësuar lartë nga të gjithë të anketuarit¹³ edhe në ato rajone ku është kritikuar puna e institucioneve tjera të sigurisë.

Pjesëmarrësit e diskutimeve në grupin e fokusit në Pejë/Peç vunë në pah rëndësinë e **Agjensionit Kosovar të Pyjeve**¹⁴. Pjesëmarrësit u shprehën se ky institucione ka vepruar si të ishte mekanizëm i sigurisë, sidomos gjatë zjarreve të egra të shfaqura në verën e vitit 2007. Sidoqoftë, mosefikasiteti i përgjithshëm i Agjensionit Kosovar të Pyjeve në parandalimin e dëmeve të shkaktuara në pyjet e rajonit të Pejë/Peç është parë si fakt shqetësues, sidomos për shkak të prerjes ilegale të pyjeve. Të anketuarit në përgjithësi kanë shfaqur mirënjohjen e tyre për paraqitjen e **Trupave Mbrojtëse të Kosovës** dhe të **KFOR-it**, përpos në Gračanica/Graçanicë ku një numër i serbëve të Kosovës shfaqën pakënaqësinë e tyre me KFOR-in në rajonin e tyre¹⁵.

Sa i përket **Shërbimit Doganor** pjesëmarrësit në debate, sidomos ata në Pejë/Peç, shfaqën pakënaqësinë e tyre në lidhje me importimin e pakontrolluar të mallrave për konsum. Pjesëmarrësit gjithashtu thanë se janë importuar barërat me afat të skaduar dhe se ata konsiderojnë se institucionet vendore duhet t'i mbrojnë nga intoksikimi ose kontaminimi me ushqime dhe barëra të importuara. Pjesëmarrësit në Pejë/Peç konsiderojnë se **Shërbimi Doganor** dhe **Policia Kufitare** nuk i kanë luftuar mjaft këto aktivitete. Krahas kësaj ekzistonte opinioni mbi nivelin e korrupsionit në mesin e të punësuarve në Shërbimin Doganor.

4.3. Perceptimi nga këndvështrimi i komuniteteve

Diskutimet me shqiptarët e Kosovës të cilët jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica, një rajon ky i banuar nga një shumicë e Serbëve të Kosovës, shfaqën pakënaqësinë e tyre me situatën e sigurisë. Pjesa më e madhe e debatit ishte e fokusuar në diskutimet mes përfaqësuesve të **Shërbimit Policor të Kosovës** dhe të anketuarve shqiptar të Kosovës.

Shqiptarët e Kosovës thanë se nuk ndjehen të sigurt në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica, përkundër faktit se aty kishte pika kontrolli të KFOR-it dhe të policisë që operojnë 24 orë gjatë shtatë ditëve të javës. Ata thanë se gjatë orëve të pasmesnatës zyrtarët e policisë zakonisht qëndrojnë brenda makinave të tyre dhe flenë gjumë, dhe se par këtë arsye nuk ka siguri të mjaftueshme dhe besim karshi Shërbimit Policor të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica dhe njerëzit nuk do t'i raportojnë rastet. Ata kërkuan patrullime më proaktive përreth lagjeve të tyre. Situata paraqiste rrezik potencial për sigurinë e tyre personale për shkak të, siç thanë ata, aktiviteteve ekstremiste në këtë rajon. Në këtë rajon ura e cila e lidh pjesën veriore dhe atë jugore të Mitrovicë/Mitrovica është objekti më shumë brengosës për sigurinë se sa si linjë e ndarjes administrative.

¹³ Si psh. serbët e Kosovës në Gračanica/Graçanicë apo dhe shqiptarët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica.


¹⁴ Agjensioni Kosovar I Pyjeve vepron nën Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është e obliguar që t'i menaxhoj burimet pyjore që të rrisë vlerën e pyjeve, të mirave pyjore në përputhshmëri me Ligjin për Pyjet në Kosovë No. 2003/3 të promulguar nga Rregullorja e UNMIK 2003/6 të datës 20 mars 2003.

¹⁵ Disa pjesëmarrës në Gračanica/Graçanicë ranë në kundërshti më disa përfaqësues të KFOR-it Suedez duke thënë se KFOR-I nuk ka qenë I qasshëm dhe është prezent vetëm para manastirit.

4.4. Perceptimi nga komunitetët serb

Pjesëmarrësit serb të Kosovës në debatin e grupës së fokusit në Gračanica/Graçanicë ishin shumë të frikësuar dhe ndjeheshin të lënë pas dore nga mekanizmat e sigurisë në rajonin e tyre. Ata shfaqën mosbesimin e tyre për Agjencionet e Sigurisë Publike për sa i përket kualitetit, profesionalizmit, arsimimit dhe respektimit të kodit të tyre të mirësjelljes. Shumica e tyre thanë se kriteret e rekrutimit në Shërbimin Policor të Kosovës kanë qenë joadekuate dhe të pa përshtatshme për këtë shërbim. Sipas tyre, Shërbimi Policor i Kosovës në rajonin e tyre ka qenë i paaftë dhe joefikas në luftimin e krimit të organizuar dhe në zhvillimin e hulumtimeve në përgjithësi, edhe pse gjithmonë në dispozicion dhe të gatshëm për të lëshuar tiketa në trafik.¹⁶ Ata vunë në pah, se në raste që kanë të bëjnë me sigurinë më parë preferojnë që ta thërrasin Shërbimin Zjarrfikës dhe të Shpëtimit se sa policinë.


Një tjetër rast brengosës i ngritur nga pjesëmarrësit në këtë studim ishte se kalimi i rrugëve dhe ecja pranë rrugëve në Gračanica/Graçanicë pas mesnate konsiderohej si e rrezikshme për shkak të provokimeve. Që të gjithë ishin të shqetësuar kur familjarët e tyre ishin jashtë pas mesnate. Të tjerët shtuan se ata preferojnë që t'i përcjellin fëmijët e tyre në shkollë se sa që t'i lënë ata të ecin vetë të pashoqëruar për shkak të largësisë përgjatë rrugës kryesore e cila qon për në shkollë.



Grafika 5: Perceptimi nivelit të lartë të rrezikshmërisë i ndarë sipas komuniteteve (*RAE: Romë, Ashkali, Egjiptian)

Të anketuarve u është parashtruar pyetja: “A ndjeni se ka nivel të lartë të rrezikshmërisë?”, dhe pastaj përgjigjet e tyre janë ndarë sipas komuniteteve të ndryshme. Në mesin e komuniteteve joshqiptare, 24 % e të anketuarve serb të Kosovës janë përgjigjur se niveli i rrezikshmërisë është i lartë, të pasuar nga komuniteti romë, Ashkali dhe Egjiptian i Kosovës me 23%, si dhe 20 % të komunitetit boshnjak të Kosovës. Vetëm 18 % e të anketuarve turq të Kosovës thanë se ndjejnë nivel të lartë të rrezikshmërisë. Në krahasim me, 15 % të të anketuarve shqiptarë të Kosovës të cilët thanë se ndjejnë nivel të lartë të rrezikshmërisë.

¹⁶ Disa pjesëmarrës të Shërbimit Policor të Kosovës e quajtën “Policia e Njesisë Statistike të Kosovës” që janë të aftë vetëm të mbledhin të dhëna statistikore.



Grafika 6: Perceptimi i nivelit të lartë të rrezikshmërisë i ndarë sipas rajoneve


Është me interes që të përmenden dallimet rajonale në përgjigjen në këtë pyetje. Përdherisa 33 % e të gjithë të anketuarve që jetojnë në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica besojnë se në rajonin e tyre kishte nivel të lartë të rrezikshmërisë, vetëm 8 % e të anketuarve në Ferizaj/Uroševac mendojnë se ka nivel të rrezikshmërisë.

Duke e shikuar këtë dallim në përgjigje, një numër shpjegimesh mund të supozohen. Perceptimet e shfaqura nga banorët e rajonit të Ferizaj/Uroševac, shifrat pozitive nga ky rajon mund t'i atribuohen shkallës së ulët të papunësisë për shkak të prezencës së bazës ushtarake të SHBA-ve “Kamp Bondsteel” i cili gjendet afër Ferizaj/Uroševac, ku janë të punësuar rreth 2,000 punëtor vendor si dhe për shkak të prezencës ushtarake në këtë rajon. Tensionet e vazhdueshme mes komuniteteve në qytetin e Mitrovicë/Mitrovica dhe në rajonin e gjerë mund të merren si shpjegim për numrin e lartë të të anketuarve në atë rajon të cilët thanë se “ndjejnë një nivel të lartë të rrezikshmërisë në ambientin e tyre”.

5. MARRËDHËNIET MES PUBLIKUT DHE AFRUESVE TË SIGURISË

Marrëdhëniet në mes të institucioneve për siguri dhe publikut janë vendimtare ngase institucionet e sigurisë mbështeten në kontaktet ditore me popullatën. Ky hulumtim është fokusuar në qasjen e Shërbimit Policor të Kosovës. Shumica e të anketuarve (56%) theksuan se në përgjithësi ata nuk kanë pasur ndonjë kontakt me zyrtarët e Shërbimit Policor të Kosovës. Sidoqoftë, analizat më të detajuara të përgjigjeve të dhëna kanë shfaqur se nuk është ashtu. Edhe pse të anketuarit janë përgjigjur haptazi në të gjitha pyetjet e parashtruara në këtë sondazh, ishte më se evident kundërshtimi që të thellohen në përgjigjet që kanë të bëjnë me kontaktin me zyrtarët e policisë edhe pse shumë prej tyre thanë se kishin përvojë nga disa raste: si dëshmitar, gjatë hetimeve apo si pjesëmarrës në komunikacion. Sidoqoftë, shumë prej tyre thanë se ata e besojnë Shërbimin Policor të Kosovës si institucion por nuk ishin të gatshëm të flasin për kontaktet e tyre personale me zyrtarët e policisë. Shumica e tyre thanë se ata kurrë nuk janë kontaktuar nga një zyrtarë policie dhe se ata do ta kontaktonin Shërbimin Policor të Kosovës vetëm nëse do ta kërkonte rasti. Krahas kësaj, shpesh është thënë se ka disa mangësi në të shprehurit e zyrtarëve të policisë së Kosovës si dhe në sjelljen e tyre.

Në pyetjen e anketuesve: “A do t’ia raportojë krimin Shërbimit Policor të Kosovës?” 86 % e të anketuarve kanë deklaruar se do t’ia raportonin Shërbimit Policor të Kosovës çfarëdo krimi. Mirëpo, 11% e të anketuarve fare nuk do ta raportonin rastin dhe një numër shumë i vogël nuk është përgjigjur në këtë pyetje.



Grafika 7: Gatishmëria për t'ia raportuar krimet Shërbimit Policor të Kosovës

Gatishmëria e shfaqur e të të anketuarve për të raportuar krimin (86%) është shumë e lartë. Niveli aktual i raportimit të krimit në shumë vende të Evropës nuk e arrinë një nivel të tillë. Sidoqoftë, dilemat nëse gatishmëria e tillë reflektohet edhe në raportet e policisë mbetet, duke e pasur parasysh faktin se që të gjithë të anketuarit kanë vënë në spikamë rëndësinë e anonimitetit dhe ruajtjes së identitetit gjatë raportimit të krimit. Në këto rrethana kjo siguri mund të vëhet në pyetje.

Në këtë kontekst, një pikë tjetër relevante është vënë në pah: në Kosovë, sipas ekspertëve ndërkombëtarë¹⁷, krimet e rëndomëta janë relativisht të ulëta.. Problem kryesor janë krimi i organizuar dhe korrupcioni.


Gjatë debatit të grupit të fokusit në Prishtinë/Priština përfaqësuesi i **Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit** u shpreh se ekzistojnë disa probleme për sa i përket bashkëpunimit mes publikut dhe Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit. Ai tha se kur njerëzit i raportojnë zjarret në linjën emergjente, ata i japin adresat e vjetra gjë që e vështirëson identifikimin e objekteve të përfshira në zjarr nga ana e zjarrfikësve, gjë që e vonon operacionin e shpëtimit.¹⁸ Krahas kësaj, ai potencoi edhe rastet e rreme të cilat raportohen nga qytetarët në linjën emergjente gjë që shkakton probleme të paparashikueshme.

Të pyetur për tri burimet e informatave mbi Shërbimin Policor të Kosovës, përgjigja kryesore ishte televizioni (78 %), radio (40%) dhe mediat e shkruara (38%). 14% e të anketuarve ishin të informuar përmes internetit

Për 38% të të anketuarve burim informate mbi punën e Shërbimit Policor të Kosovës ishin miqtë, komshijët dhe vrojtimet personale.

¹⁷ Raporti i zyrës së KB mbi Drogat dhe Krimet “Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan”, Mars 2008.

¹⁸ Si përgjigje në këtë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Departamenti për Siguri Publike i OSBE-së në dhjetor të vitit 2007 kanë udhëhequr një kampanjë promovuese “Çfarë të bëjmë në rast të emergjencave?”



Grafika 8: Burimi i informatës mbi Shërbimin Policor të Kosovës

Nuk kishte ndonjë indikacion se njerëzit do ta thërrisnin policinë drejtpërdrejtë apo edhe se do ta pyesnin zyrtarin e policisë për informata. Rezultatet lënë për t'u kuptuar se Shërbimi Policor i Kosovës mbase duhet ta rishqyrtoj strategjinë e vet të komunikimit me publikun duke përfshirë këtu edhe aktivitetet që nënkuptojnë komunikimin e drejtpërdrejtë me publikun.

Gjatë implementimit të hulumtimit në nëntor të vitit 2007 shumë nga të anketuarit nuk ishin në gjendje që të flasin mbi punën e disa prej institucioneve të sigurisë. Arsye kryesore për këtë ishte se ata nuk e dinin se këto institucione ekzistojnë apo dhe se çfarë shërbimesh i ofrojnë popullatës. Sa i përket Shërbimit Policor të Kosovës është vërejtur se shumë nga të anketuarit për herë të parë kanë dëgjuar për zyrtarët e policisë në komunitet, përmes pyetësorëve. Njerëzit shpesh kanë deklaruar se ata nuk e kanë ditur se çfarë bëjnë këta zyrtarë dhe se ata nuk e dinin se përse do duhej t'iu drejtohen atyre. Edhe pse policia në komunitete për shkak të natyrës së punës do duhej të jetë “qelës në komunikim me popullin” nga Shërbimi Policor i Kosovës është konfirmuar se njësitë e policisë në komunitet nuk kanë një zyrtarë të vetin për informim dhe se këto njësi nuk janë pjesë e strukturës së komunikimit dhe qasjes publikut në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës.

6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Rezultatet e këtij hulumtimi të opinionit vënë në pah se në përgjithësi kampanjat për komunikim me publikun janë iniciuar vetëm pas shfaqjes së suksesshme të besueshmërisë së komunitetit ndërkombëtar, në ofruesit e shërbimeve të sigurisë publike siç është Shërbimi Policor i Kosovës. Kjo është sidomos relevante meqenëse opinioni i përgjithshëm karshi policisë para vitit 1999 ka qenë shumë negativ.

Sidoqoftë, është gjithashtu e qartë se disa raste të sjelljes së padëshirueshme në paraqitjen e disa individëve të Shërbimit Policor të Kosovës në terren kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në perceptimin e opinionit të publikut. Prandaj, banorët e Kosovës kanë nivel të lartë të besueshmërisë në institucionet e sigurisë publike si të tilla, dhe ndonjëherë edhe

përkundër mangësive në pajisje adekuate dhe standarde, por shfaqin mosbesueshmëri serioze në to duke u mbështetur në përvojat personale me policinë.

Është me rëndësi që të theksohet se edhe përkundër suksesit të kampanjave të lartpërmendura për marrëdhënie më publikun në përmirësimin e imazhit të ofruesve të shërbimeve të sigurisë publike në sytë e publikut të gjerë, këto agjenci dhe institucione megjithatë ende kanë mangësi në strategjinë e komunikimit kur ka të bëjë me njoftimin e popullatës mbi punën e bërë nga këto shërbime për popullin. Kjo është shumë e rëndësishme kur bëhet fjalë për përforcimin e komunikimit në të gjitha nivelet mes popullatës dhe agjensioneve, e sidomos karshi Shërbimit Policor të Kosovës.

Mangësi serioze të identifikuar tashmë edhe nga ekspertët ndërkombëtar në të kaluarën janë vënë në dukje edhe këtu nga të anketuarit, duke i dhënë një mesazh të qartë të autoriteteve vendore se këto mangësi duhet të adresohen në mënyrë të duhur dhe të përmirësohen.

Mangësitë kryesore të identifikuar nga publiku përmes këtij hulumtimi janë:

- Niveli i mosbesueshmërisë mes grupeve të ndryshme etnike mbetet shumë i lartë, prandaj e bënë të vështirë dhe përparimin në drejtim të një shoqërie multietnike në Kosovë. Ky mosbesim ka ndikim në perceptimin e publikut për paraqitjen e individëve në Agjensionet për Siguri Publike, e në veçanti të Shërbimit Policor të Kosovës.
- Publiku seleksionimin dhe procedurat e trajnimit të pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës i sheh si jo të kompletuara sa duhet. Kjo duket sidomos e vërtetë kur bëhet fjalë për perceptimin e publikut për zyrtarët e lartë.
- Mangësitë në sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe çështja e mbrojtjes së identitetit të informatorëve të policisë mbete brenga kryesore për publikun e Kosovës.
- Publiku i gjerë duket se nuk është i njoftuar mbi ekzistencën dhe punën e institucioneve të ndryshme me relevancë, siç është Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit. Është shumë e vështirë t'i besosh sistemit institucional kur njerëzit nuk kanë njohuri të mjaftueshme.
- Publiku është i brengosur për implikimet e sigurisë si pasojë e hyrjes në Kosovë të një numri të pakontrolluar të medikamenteve dhe ushqimeve të skaduar. Kjo brengë reflekton në besimin e ulët karshi Shërbimit Doganor.
- Publiku është i informuar dhe i brengosur mbi kushtet e dobëta dhe mangësitë në pajisje të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, në veçanti të Shërbimit Zjarrfikës dhe të Shpëtimit.
- Brengat e përditshme të sigurisë publike janë të ndërlidhura me çështjet siç janë parkimi ilegal i automjeteve, pasiguria në oborret e institucioneve shkollore dhe vjedhjet me thyerje. Prandaj ngritja e përkushtimit institucional për zgjidhjen e këtyre çështjeve do ta përmirësonte pozitivisht perceptimin e publikut dhe besueshmërinë ndaj këtyre institucioneve.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT “VLERËSIMI I BESUESHMËRISË”

Hulumtimi “Vlerësimi i besueshmërisë” i cili është bërë në mbarë Kosovën, reflekton perceptimin e publikut në punën e institucioneve vendore për siguri publike në Kosovë.

Hulumtimi është bërë në nëntor dhe dhjetor të vitit 2007 gjatë kohës së negociatave për status.

Mostra përbëhej nga 1,700 intervista individuale dhe shtatë debate në grupe të fokusit, me pjesëmarrje të 200 pjesëmarrësve. Mostra për intervista individuale është përpiluar nga tri nën mostra me 1360 shqiptar të Kosovës dhe 340 joshqiptar të moshës prej 18 vjeç.

Përzgjedhja e 1,700 të anketuarve është bërë duke përdorur metodologjinë e përzgjedhjes me shans (the random walk technique) duke respektuar përqindjen e komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë

Rajoni	Komuna	Komunitetet etnike			Totali	
		Shqip-KS 80%	Serb-KS 11.76%	Të tjerë 8.24%	Numri	Përqindja
Prishtinë/ Prishtina	Prishtinë/Priština, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Shtime/Štimlje, Glogovac/Glogovac,	449	66	46	561	33%
Mitrovicë/ Mitrovica	Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok, Zvečan/Zvečan, Vushtri/Vučitrn, Leposaviq/Leposavić, Skenderaj/Srbica	231	34	24	289	17%
Gjilan/ Gnjilane	Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitine, Novobrdë /Novobërdë, Gjilan/Gnjilane	136	20	14	170	10%
Pejë/ Peć	Pejë/Peć, Istog/Istok, Klinë/Klina, Deçan/Dečane, Gjakovë/Djakovica, Rahovec/Orahovac	231	34	24	289	17%
Ferizaj/ Uroševac	Ferizaj/Uroševac, Shtërpçë/Štrpce, Kaçanik/Kaçanik	82	12	8	102	6%
Prizren	Prizren, Suharekë/Suva Reka, Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo	231	34	24	289	17%
Totali		1360	200	140	1700	100%

Pyetëtori dhe debatet e grupeve të fokusit

Hulumtimi ka adresuar 1,900 qytetar të Kosovës nga dy grupet e mëposhtme, dhe ka përfshirë (a) intervista individuale, dhe (b) intervista në grup - debate të grupeve të fokusit:

a) Intervistat individuale/Pyetësorët (Indikatorët kuantitativ): Mostër mbarë kosovare që përfaqëson diversitetin në moshë, gjini, arsimim, urban/rural, statusin social;

b) Debatet në grupe të fokusit (Indikatorët kualitativ): në përgjithësi shtatë debate në grupe të fokusit janë mbajtur në tërë Kosovën për të mbledhur indikatorët kualitativ për paraqitjen e sektorit të sigurisë të Kosovës.

Pyetjet të cilat janë përdorur në intervistat individuale dhe në debatet e grupeve të fokusit:

- Cili është niveli i kënaqësisë mbi sigurinë dhe çfarë ndjeni për paraqitjen e mekanizmave të sigurisë?
- Ku/si i merrni informatat mbi mekanizmat e sigurisë në Kosovë?
- Cilat mekanizma/institucione të sigurisë janë ende larg pritjeve tuaja?
- Çfarë mendoni cili është rreziku më i mundshëm i cili do ta destabilizonte Kosovën?
- Cilit institucion i besoni më së shumti?
- Sa jeni të kënaqur me paraqitjen e institucioneve të sigurisë?
- Sa kompetent mendoni se është Shërbimi Policor i Kosovës?
- Si e vlerësoni nivelin e rrezikut në Kosovë?
- A ndjeni nivel të lartë të rrezikshmërisë?
- A do t'ia raportoni Shërbimit Policor të Kosovës ndonjë krim?
- Ku i merrni informatat për Shërbimin Policor të Kosovës?

1,700 pyetësorët e mbledhur janë proceduar në Paketën Statistikore për Shkenca Sociale-PSSS (Statistical Package for Social Sciences – SPSS).

Debatet, në të cilat morën pjesë përafërsisht **200 pjesëmarrës**, janë regjistruar haptazi në kasete. Shtrirja e tillë është planifikuar që t'i bashkoj të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë si, institucionale (lokale dhe regjionale), komunave, përfaqësuesit e agjensioneve të sigurisë (si Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, KFOR, Shërbimi Zjarrfikës dhe i Shpëtimit, Ambulancat etj), drejtorët e shkollave, shoqata të ndryshme nga shoqëria civile, qytetarët, gazetarët, përfaqësues prej projekteve të ndryshme (që kanë të bëjnë me gratë, të rinjtë, fermerët, shoqërinë civile, etj)